

**VENDIM**  
**Nr. 410, datë 13.5.2015**

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT**  
**SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të neneve 11 e 51, pika 3, të ligjit nr.10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 1, të nenit 23, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr.8734, datë 1.2.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. KRIJIMI I INSPEKTORATIT SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL**

1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (në vijim ISHTI) është institucioni qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë (në vijim ministria) me kompetenca inspektimi.

2. Ministria mbështet funksionimin efektiv të ISHTI-së. Në këtë përgjegjësi nuk përfshihet drejtimi operacional i veprimtarisë së inspektimit.

**II. MISIONI DHE FUNKSIONET E ISHTI-SË**

1. ISHTI-ja është struktura përgjegjëse për inspektimin për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e:

a) përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës;

b) sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sipas legjislacionit përkatës;

c) sigurisë së punës së instalimeve nën presion, si një linjë teknologjike e përbërë nga enë, tubacione dhe aksesore sigurie dhe që shërbejnë për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve, sipas legjislacionit për sigurinë e enëve në presion;

ç) sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen, depozitimin, si dhe ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror, sipas legjislacionit të sektorit të gazit natyror;

d) sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë joushqimore, brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për industrinë, sipas legjislacionit përkatës;

dh) çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor.

2. ISHTI-ja është organ qendror dhe ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e vendit.

**III. MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE E FUNKSIONIMIT TË ISHTI-SË**

1. ISHTI-ja organizohet si drejtori e përgjithshme, në nivel qendror, me seli në Tiranë.

2. ISHTI-ja drejtohet nga kryeinspektori, i cili ka këto përgjegjësi:

a) Përfaqëson këtë institucion në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit, si dhe për cilësinë e efektivitetin e veprimtarisë së ISHTI- së;

b) Zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të ISHTI-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell ministrit;

c) Nxjerr urdhra dhe udhëzime për veprimtarinë e strukturave të ISHTI-së në fushën e inspektimit që ai mbulon;

ç) Bashkërendon veprimtarinë e ISHTI-së me organet qendrore dhe organet e tjera shtetërore në fushën përkatëse të inspektimit;

d) Siguron kontakte me organe homologe dhe organizata të ndryshme të huaja, për zgjidhjen efektive të problemeve në fushën e inspektimit;

dh) Siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit që ISHTI-ja mbulon;

e) I propozon për miratim ministrit rregulloren e brendshme të ISHTI-së dhe mbikëqyr zbatimin e saj.

3. Kryeinspektori i raporton ministrit periodikisht dhe sipas kërkesës për veprimtarinë e institucionit, përveçse kur ministri ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi në aparatit e ministrisë përgjegjëse.

4. ISHTI-ja si institucion ka këto funksione:

a) Planifikon, bashkërendon dhe realizon veprimtarinë e inspektimit;

b) Siguron unifikimin e praktikave të inspektimit, brenda fushës së përgjegjësisë, në shkallë vendi;

c) Bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve të saj dhe, në rastin e pamundësisë teknike së kryerjes së tyre nga laboratorët e saj, siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të tjerë të akredituar;

ç) Informon publikun për veprimtarinë e inspektimit;

d) Jep mbështetje teknike, administrative dhe shkencore për veprimtarinë e inspektimit;

dh) Përgatit programin e raportin vjetor të inspektimit dhe raportin mbi rastet e veçanta të inspektimit të kryera jashtë programit;

e) “Kryen, sipas programit vjetor të miratuar paraprakisht prej ministrisë, inspektime të drejtpërdrejta në gjithë territorin e vendit në një apo disa fusha të caktuara inspektimi, si dhe inspektime të drejtpërdrejta të paplanifikuara për raste të veçanta, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, ndaj subjekteve që kryejnë veprimtari me rrezik të lartë”;

ë) Kryen funksionet e shërbimeve të brendshme mbështetëse, të menaxhimit financiar dhe të auditimit të brendshëm;

f) Kryen çdo funksion tjetër, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

5. Pranë ISHTI-së krijohet “Komisioni i ankimit”, që do të shërbejë për shqyrtimin e ankimeve administrative kundër vendimeve përfundimtare të ISHTI-së sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative. Përbërja dhe funksionimi i këtij komisioni miratohen me urdhër të ministrit, pas propozimit të ISHTI-së.

6. Komisioni i ankimit drejtohet nga Krye-inspektori dhe ka në përbërje:

a) një përfaqësues të njësisë që mbulon çështjet juridike;

b) një përfaqësues që mbulon fushën e veprimtarisë së objektit të inspektimit;

c) dy specialistë të tjerë të ISHTI-së që nuk përfshihen në inspektime të drejtpërdrejta.

7. Struktura dhe organika e ISHTI-së miratohen me urdhër të Kryeministrit. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të ISHTI-së rregullohen sipas ligjit të nëpunësit civil.

#### IV. STEMA DHE VULA ZYRTARE E ISHTI-SË

1. ISHTI-ja identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.

2. Stema e ISHTI-së përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet:

“Republika e Shqipërisë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial”.

3. Vula e ISHTI-së përmban dhe shënimin identifikues “Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial”.

#### V. DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

1. Kryeinspektori i Inspektoratit, i emëruar nga ministri përgjegjës, vazhdon të qëndrojë në detyrë dhe konsiderohet i emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Çdo dispozitë apo akt nënligjor, që vjen në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

3. Kudo ku në akte të tjera nënligjore referohet Inspektorati Qendror Teknik, konsiderohet që referohet Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

4. Dispozitat e këtij vendimi në lidhje me mënyrën e rekrutimit të nëpunësve të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, sipas pikës 7, të kreut III, të këtij vendimi, i shtrijnë efektet gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe ISHTI-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**